

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 92, datë 27.07.2020

**“PËR  
MIRATIMIN E KONTRATËS SË SIPËRMARRJES MIDIS BASHKISË TIRANË  
DHE SUBJEKTIT STARTEK SHPK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 8250, 8240, 8190, 8150”, të ndryshuar, vendimit nr. 53, datë 26.04.2018, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”, vendimit nr. 47, datë 29.04.2020, të Këshillit Bashkiak “Për zhvillimin e pronave nr.1/921, nr.1/188 dhe nr.1/922, zona kadastrale 8250, ne pronësi të Bashkisë Tirane dhe miratimin e marrëveshjes se sipërmarrjes midis Bashkisë Tirane dhe Subjektit Startek SHPK” me propozim të kryetarit të Bashkisë, këshilli bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kontratës së sipërmarrjes/shkëmbimit, Nr. 7566 Rep, Nr. 2918 Kol, datë 20.07.2020, të nënshkruar midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit zhvillues “Startek” shpk, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Data e hyrjes në fuqi të kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pas miratimit nga këshilli bashkiak.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**